



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNIILANE/MUNICIPAL GILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr."Adem Jashari", pn, vvvgjilani-komuna.org; zip gjilan@hotmail.com, tel.028/20 781, 20 782, 21 482.

Në bazë të neneve 22 dhe 23 të Ligjit për ndërtim, nr. 04/L-110, nenit 17 të Ligjit për financat e pushtetit lokal, nr. 03/L-049, neneve 12 dhe 17 të Ligjit për vetëqeverisje lokale 03/L-040, nenit 39, nënparagrafi 1.4 dhe neni 49 paragrafi 2 nënparagrafët 2.8 të Statutit të Komunës së Gjiçanit 01.nr. 16-53125, dt. 11.11.2011, dhe të Udhëzimit administrativ mbi taksat administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës, nr. 22/2012, dt. 19.11.2012, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit, në mbledhjen e mbajtur më 17.07.2013, merr këtë

V E N D I M

Mbi taksat administrative për lëshimin e Lejes së Ndërtimit dhe Tarifat
për ndikimet nga rritja e densitetit dhe infrastrukturës për vitin 2013

Neni 1

1. Miratohet Vendimi për llogaritjen e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifat për ndikimet nga rritja e dendësitetit të infrastrukturës, për vitin 2013.(në tekstin e mëtejshëm: vendimi për taksë dhe tarifa për leje të ndërtimit).
2. Me këtë vendimin caktohen: kriteret, obliguesi, baza, lartësia, lehtësitë dhe procedurat për llogaritjen e taksës dhe tarifës për leje ndërtimi, për vitin 2013.
3. Tarifa për infrastrukturë caktohet me marrëveshje të veçantë (marrëveshje për zhvillim) në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore.

Neni 2

1. Kriter për llogaritjen e taksës dhe tarifës për leje të ndërtimit është buxheti i domosdoshëm i organeve kompetente komunale për dhënien e lejes së ndërtimit, mbikëqyrja e ndërtimit dhe inspektimi i ndërtimit, i pjesëtuar me numrin total të metrave katrorë të lejuar me leje ndërtimore nga viti paraprak.
2. Kriteret për llogaritjen e tarifës për ndikim nga rritja e dendësitetit të infrastrukturës, janë shpenzimet e buxhetit të Komunës së Gjiçanit në arsim, përkujdesje shëndetësore, shërbime publike, mbrojtje dhe shpëtim, kulturë, rini e sport.

Neni 3

Obligues i pagesës së taksës nga neni 2 i këtij vendimi, është aplikuesi – poseduesi i lejes së ndërtimit.

Neni 4

1. Llogaritja e taksës nga paragrafi 1 dhe 2 të nenit 2 të këtij vendimi, bëhet në m² bruto të objektit për të cilin është dhënë pëlqimi në dokumentacionin teknik – projektin kryesor, në bazë të të cilit lejohet ndërtimi.
2. Llogaritja e taksës nga par. 1 i këtij neni, bëhet me vendim të veçantë, të lëshuar nga organi kompetent komunal për punë të urbanizmit.

Neni 5

Bazë për llogaritjen e taksës për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe tarifat për ndikimet nga rritja e dendësitetit të infrastrukturës, sipas këtij vendimi, paraqet projekti kryesor, në bazë të të cilit lejohet ndërtimi.

Neni 6

1. Taksa administrative për dhënien e lejes së ndërtimit, për vitin 2013, do të jetë 2.56€/m².
2. Lartësia e tarifës për ndikimet nga rritja e dendësitetit të infrastrukturës, për vitin 2013, do të jetë 118.2€.
3. Baza dhe mënyra e llogaritjes së lartësisë së taksës, si në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, është dhënë në tabelën e shpenzimeve për leje të ndërtimit dhe shpenzimet për kalkulimin e tarifave rregullative për rritjen e dendësisë së infrastrukturës, për vitin 2013, të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi.
4. Vendimi për llogaritjen e taksës dhe tarifës nga paragrafin 1 dhe 2 i këtij neni, bëhet konform formularit zyrtar në pajtim me ligjin.
5. Afati për pagesën e taksës, sipas këtij vendimi, fillon ditën kur aplikuesi siguron provat e kryerjes së pagesës brenda pesë (5) ditësh pas dorëzimit të aplikacionit dhe marrjes së informacionit për taksën.
6. Leja e ndërtimit nuk mund të jepet në dorëzim pa provën mbi pagesën e kompensimit të llogaritur, e të arritur për pagesë.
7. Nëse pagesa e kompensimit të llogaritur nuk bëhet brenda afatit të paraparë ligjor, pezullohet procedura e lëshimit të lejes së ndërtimit, me arsyetim të trajtuar si heqje dorë nga kërkesa për leje ndërtimi.
8. Ankesa e paraqitur kundër vendimit mbi llogaritjen e taksës, sipas këtij vendimi, nuk e shtyn afatin për pagesë, e as nuk ndalon veprimet e organit, të parapara në paragrafin 5 të këtij neni.

Neni 7

1. Nga lartësia e taksës administrative, e përshkruar në nenin 6, paragrafi 1 dhe 2 do të lirohen poseduesit e lejeve të lëshuara për objektet e interesit publik, të ndërtuara nga investimet kapitale të Komunës dhe niveli qendror, të ndërtimeve për nevojat e zgjidhjes së çështjes së banimit të rasteve sociale me investime në bazë të donacioneve, personat me aftësi të kufizuara, invalidëve të luftës dhe familjeve të ngushta të dëshmorëve, objekteve për përfaqësuesit diplomatikë, ku investuese janë shtetet e huaja, dhe objektet me destinim fetar.

Neni 8

1. Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, q'fuqizohet pika 4.5, 4.7, 4.8, 4.12, 4.16, 4.17, 4.18, 4.19, 4.20, 4.21, 4.22, 4.23, 4.24, 25 dhe 4.26 të paragrafit 1 neni 6. si dhe paragrafi 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 të po këtij neni të Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale 01. Nr. 1610498, dt. 30.01.2013

Neni 9

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ëeb faqen e Komunës.

01.Nr. 16-69016
Gjilan, më 17.07.2013

Kuvendi i komunës,,

Izmi Zeka, Kryesues

ARSYETIMI

Sipas neneve 22 dhe 23 të Ligjit për ndërtim, 04/L-110, është paraparë që Komuna të caktojë taksë administrative dhe taksë për infrastrukturë për dhënien e lejeve të ndërtimit për çdo vit kalendarik.

Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor e Republikës së Kosovës, ka nxjerrë Udhëzimin administrativ, nr. 22/2012, dt. 19.11.2012, mbi taksat administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës.

Me qëllim të zbatimit të dispozitave të ligjit në fjalë nga aspekti i përcaktimit të taksave për dhënien e lejeve të ndërtimit, Kryetari i Komunës së Gjilanit, me Vendimin 01 nr. 124, dt. 25.02.2013, ka formuar grupin punues, në përbërje prej pesë anëtarëve nga lëmi i urbanizmit, inspektionit, shërbimeve publike dhe prokurimit.

Detyrë e këtij grupi punues ka qenë që të analizojë dhe të nxjerrë shënime të nevojshme për caktimin e lartësisë së taksës administrative, sipas dispozitave të parapara me ligjin në fjalë, përkatësisht të përcaktojë shpenzimet e nevojshme për lëshimin e lejeve të ndërtimit, mbikëqyrjen ndërtimore dhe mbikëqyrjen inspektuese, si dhe ndikimet nga rritja e dendësisë në infrastrukturë.

Pas llogarive të këtij komisioni për shpenzimet e nevojshme dhe ndikimet e rritjes së dendësisë në infrastrukturë, të pjesëtuara me numrin e m² të lejeve të lëshuara gjatë vitit 2012 dhe numrit të popullsisë së komunës së Gjilanit, ashtu siç parashihet me nenin 22, pikat 4.1, 4.2 dhe 4.3 të Ligjit të ndërtimit, nr. 04/L-110, dhe dispozitave të Udhëzimit administrativ nr. 22/2012, dt. 19.11.2012, mbi taksat administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës, ka rezultuar lartësia e taksës si në këtë propozim vendim.